



SIGURIA KIBERNETIKE NË SEKTORIN E SHËNDETËSISË


TRENDET 2023



Vulnerabilitetet në sektorin shëndetësor do të vijojnë të jenë kërcënim në rritje për vitin 2023

Agjencia e Bashkimit Evropian për Sigurinë Kibernetike (ENISA) ka publikuar raportin e saj të parë të kërcënimeve kibernetike për sektorin e shëndetësisë.

Raporti zbuloi se ransomware përbën 54% të kërcënimeve të sigurisë kibernetike në këtë sektor për periudhën Janar 2021 - Mars 2023.



Përhapja e incidenteve kibernetike

Sektori shëndetësor ka përjetuar 53% të numrit total të incidenteve në nivel Evropian.

Nga të cilat, 42% e incidenteve kanë ndodhur në institucione spitalore, 14 % në agjencitë dhe autoritetet shëndetësore, si dhe 9% në institucionet farmaceutike.

01




Ransomware dhe çënim i të dhënave

Të dhënat e pacientëve, duke përfshirë të dhënat elektronike shëndetësore, janë asetet më të synuara (30%).

Rreth gjysma e incidenteve (46%) kishin për qëllim vjedhjen ose publikimin e të dhënave të organizatave shëndetësore.

02



Sulmet gjatë COVID - 19

Aktorë të motivuar financiarisht, të nxitur nga vlera e të dhënave shëndetësore, janë përgjegjës për shumicën e sulmeve (53%).

Gjatë pandemisë u regjistruan raste të shumta të rrjedhjes së të dhënave nga sistemet e lidhura me COVID-19 dhe laboratorët e testimit në vende të ndryshme të BE-së.

03



Vulnerabilitetet

- 7 % e sulmeve ndaj zinxhirëve të furnizimit të kujdesit shëndetësor (supply chain) dhe ofruesve të shërbimeve rezultuan në ndërprerje ose humbje të organizatave shëndetësore.
- 80% e organizatave cilësojnë vulnerabilitetet si shkak të incidenteve të tyre të sigurisë, në më shumë se 61% të rasteve

04



Pasoja e incidenteve

- 43 % e incidenteve kanë rezultuar kryesisht në shkelje ose vjedhje të të dhënave (43%);
- 22% e tyre rezultuan në ndërprerje të shërbimeve të kujdesit shëndetësor;
- 26% e incidenteve rezultuan në ndërprerjen e shërbimeve të tjera, që nuk lidhen me kujdesin shëndetësor

05